

A K T T H E M E L M I



I

SHOQERISE "INFRASTRUKTURË" SHPK

Neni 1

Faruk Kaba, i biri i Jusufit, i dt.1945, me banim ne Tirane, themelon Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar "INFRASTRUKTURË" shpk.

Neni 2

Shoqeria ka statusin e personit juridik dhe vulen e saj. Selia e saj eshte ne Tirane, Rr. " 4 Dëshmoret" P.13/B, ap.3.

Neni 3

Veprimtaria e Shoqerise , mardheniet qe lindin nga ky akt themelimi si dhe mardheniet e saj me personat e trete fizike apo juridike Shqiptare apo te huaj, rregullohen sipas dispozitave te kesaj kontrate , te Statut perkates dhe te ligjes Nr.7638 date 19.11 1992 si dhe te akteve te tjera ligjore e neuligjore dale per zbatim t tij.

Shoqeria pergjigjet vetem me pasurine e saj .Ajo nuk pergjigjet per detyrimet qe mer Ortaku i vetem si person fizik tej veprimtari se es shoqerise apo tej kapitalit themelor te saj.Po keshtu Ortaku i vetem nuk pergjigjet per detyrimet e Shoqerise tej kapitalit te tij themelor ne kete shoqeri.

Neni 4

Stampa
Shoqeria ka pur objekt te veprimtarise se saj projektimin dhe zbatimin ne punime dhen, muratore, betoni, b/arme te zakonshme, punim shembjesh, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore e te tjere e kompletimin me instalimet e nevojshme per te, punime reesturimi, punime te shtracave te rrugave, ndertime vepra arti rugore si dhe prodhimin dhe tregetin me shumice e pakic ne eksport dhe import te materialeve te ndertimit.

Neni 5

Veprimtaria e Shoqerise, emertimi i saj , selia dhe objekti apo kapitali i saj nuk ma d te ndryshojene pa vendim te Ortakut te vetem.

Neni 6

Kapitali themelor i shoqerise eshte ne shumen 110.000 lek i ndare ky ne 11 kuota ku secila kuota paraqeson nje chume prej

10.000 lek.

Keto kmeta dhe njetet e kapitalit themelor regjistrohen ne librin e llogarise se Shoqerise. Ate jane te shlyeshme dhe te nenshkruashme dhe mu e te depositohen ne nje nga Bankat ne Shqiperi.

Neni 6

Jetesgjatësia e Shoqerise eshte 15 vjet pervec ndonje zgjidhje tjeter te parakoheshme apo zgjatjes se ketij afati.

Neni 8

Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shpirtjes se detyrimeve ligjore dhe fondeve te percaktuara meret nga Ortaku i vetem dhe perdoret sipas interesit te tij per edhe per te shtuar kapitalin themelor te Shoqerise.

Neni 9

Organet e Shoqerise jane :

1. Ortaku i vetem (qe aktualisht luan rolin e Administratorit) dhe Kryetorit Ekzekutiv) eshte Minella Haderaj, i emruar ky nga Ortaku i vetem.
2. Komisioni i revisionit ose ekspertëve kontabel.

Medalitetet e formimit dhe te funksionimit te tyre percaktohen ne Statutin bashkalishtur.

Neni 10

Dispozita ne te helleqishme per Shoqerine percaktohen ne Statutin bashkalishtur ketij akti.


Neni 11

Ky akt themelimi u redaktua ne kater kopje te njejta me njera tjetren.

ORTAKU I VETEM

FARUK KABA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 4604 Rep.



V E R T E T I M

Ne Tirane sot me daten Njentesgjatëse Prill 1995, ne syrat e Noterise Tirane, u paraqite Faruk Kaba, me sjenezalitate dhe adrese si me sipër i cili deklaroi se kete akt themelimi e ka redaktuar me vullnetin e tij dhe e ka nenshkruar regullisht.

**NOTERE
SHPRESA SPAHIU**



S T A T U T

I

SHOQËRIE " INFRATRANSPROJEKT " SHPK



Neni 1

Shoqëria " INFRATRANSPROJEKT " shpk, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe përfaqësohet nga Ortaku i vetëm Faruk Kaba që është dhe Administrator i saj.

Neni 2

Shoqëria ka këtë Statut që në përputhje me aktin e themelimit dhe Ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 dhe të gjitha aktet ligjore dhe nenligjore që rregullojnë pozitën juridike të veprimtarisë private ky Statut rregullon dhe pozitën juridike të Ortakut të vetëm me punonjësit në Shoqëri, të dhenat me rëndësi për qarkullimin juridik organizimin dhe objektin e veprimtarisë së shoqërisë, dhe çështje të tjera me rëndësi për punën në Shoqëri.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është projektimi dhe zbatimi në punimet e dhut, murature, betoni, h/arme, të zakonshme, punime shembjesh, ndertime civile, industriale, tuzistike, bujqesore e të tjera si dhe kompletimin me instalimet e nevojshme për të, punime restaurimi, punime të shtrëcave të rrugëve, ndertime vepra arti rrugore si dhe profhimin dhe tregtimin e çdo lloji materiale ndërrtimi me shumicë e pakice në eksport dhe import.

Me vendim të Ortakut të vetëm dhe me kërkesë në Gjykatën e rrethit të Tiranës ky objekt veprimtarije dhe mund të shtohet.

Neni 4

Selia e Shoqërisë është në Tiranë Rr. " 4 dëshmoret " P.13/b ap.3 por ajo ka të drejtë të ngrejë filiale dege a përfaqësi në të gjitha trejtorin Shqipëtar apo dhe jashtë tij në përputhje me miqjet e vendit ku ato ngrihen.

Neni 5

Kapitali themelor i Shoqërisë do të jetë në shumën 110.000 lek i ndarë në 10 kuota kapitali ky e vlera kuote është në shumën 110.000 lek çdo kuote.

Me vendim të Dërgatit të Vtem ky kapital mund të shtohet ose të pakesohet.

Neni 6

Pjesëmarrja në kapitamine themelor të Shoqërisë nuk e pengon Ortakun

e Vetem tr këte pavaresi ligjore , organizative dhe te drejtë tjera pronësie jashtë shoqërisë.

Ortaku i vetem nuk përçajijet për detyrimet e Shoqërisë së kapitalit të tij themelor. Po kashtu Shoqëria nuk përçajijet për detyrimet e Ortakut të vetem si person fizik apo dhe tej veprimtarisë së Shoqërisë të kapitalit themelor që ai ka investuar.

Neni 7

Marja në punë në Shoqëri bëhet në anë të Kontrates së Punës në të cilën përvaftihen të drejtat dhe detyrat e palëve në përputhje me Ligjin Mbi Marchenitë e Punës.

Neni 8

Shoqëria përçakton Fondin Themelor dhe Fondin rezervë. Gjate veprimtarisë së saj ajo mund të përçaktojë dhe fonde të tjera. Fondi themelor i Shoqërisë formohet nga Fondi i caktuar nga Ortaku i Vetem dhe shfrytëzohet nga Shoqëria për kryerjen e veprimtarisë së saj si dhe për të mbuluar rezikët, por pas shfrytëzimit të të fundit rezervë.

Pa përçaje rrejt shuma e përçajitshëmz , burimet, për krijimin e Fondit rezervë dhe odo fondi tjetër të veçanta caktohen nga Drejtorit Ekzekutiv.

Detyrimet e vëntuale që mund të lindin gjate veprimtarisë së shoqërisë mbulohen nga Fondi rezervë dhe nga Fondet e tjera ose nga shumat eventuale suplementare që mund të derohet Ortaku i vetem, kur këte detyrime nuk mund të ÷bulohen nga fondet ekzistues.

Neni 9.

Shoqëria në vendim të Ortakut të Vetem mund të pranohet në të edhe Ortaku të rinj të cilve ju shiten kushtat e kapitalit të saj ose ofrojnë kushtat kapitali nga jashtë.

Neni 10.

Shoqëria është pronare për ato sende që gazon këte të dëgjete për dhe për të tjera në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj. Ajo mund të blejë dhe të shfrytëzojë edhe të drejta të tjera materiale duke përçhire këtu edhe të drejtën për të ekzuar pasuritë e veta.

Neni 11

Fitimi i realizuar nga Shoqëria merret nga Ortaku i vetem dhe përdoret për interesat e tij por, edhe oer të shtuar kapitalin themelor të Shoqërisë.

Më vendim të Ortakut të vetem një pjesë e fitimit mund tju ndahet edhe punonjëeve në Shoqëri.

Neni 12

REMIKUN e humbjeve ne afazismin e Shoqerise e bart Ortaku i vetem. H
bjat kompesohen nga e tere pasuria e Shoqerise.

Neni 13 Pasurite e Shoqerise vleresohen ne bilancet e saj ne vlera te shprehura ne lek, ne perputhje me ligje Per Kontabilitetin. Parna e bilanceve dhe llogarive ekonomike percoohen nga Drejtori Ekzekutiv, ne perputhje me formen qe ndiqet dhe nga subjektet e tjera duke u mbeshtetur dhe ne Ligjen per Kontabilitetin.

Neni 14

Organet e Shoqerise jane :

1. Ortaku i vetem qe luan dhe rolin e Administratorit.
2. Drejtori Ekzekutiv.
3. Komisioni i revizionit ose eksperteve kontabel.

Neni 15

Ortaku i vetem eshte organ vendimor i Shoqerise, ai p roakton detyrimet kryesore te veprimtarise se shoqerise, miraton bilancin vjetor, vendos per ndryshimet ne statut, shtimin ose paksimin e kapitalit themelor te Shoqerise, pranimin e ertakeve te rinj, apo dhe pushimin e veprimtarise se Shoqerise.

Neni 16

Ortaku i vetem ne rolin e Administratorit eshte organ vendimor i shoqerise, ai miraton programet dhe llogarite ekonomike, emeron dhe shkarkon komisionin e revizionit ose te eksperteve kontabel, oel leter kredi ne lek dhe ne valute, perfaqeson shoqerine ne te trete, lidh kontrata, perreakton numrin e punonjesve dhe pagat e tyre.

Neni 17

Drejtori ekzekutiv qe ne kete rast eshte dhe Drejter teknik ka te drejte te perfaqesoje shoqerine ne te trete,, vepron ne te gjitha shtetet e shoqerise per ndjekjen dhe realizimin e veprimtarise se Shoqerise, lidh, nenshkruan dhe ndjek realizimin e kontratave, ben kontrollin teknik te objekteve dhe organizimin e punes ne te,, ben emrimin dhe pushimin nga puna te punonjesve kur ata shkolin kontraten e punes ose kur veprimet e tyre bien ndesh me interesat e shoqerise.

Neni 18

Per te kontrolluar veprimtarine financiare dhe ate ekonomike tregtare te shoqerise Ortaku i vetem emeron komisionin e eksperteve kontabre ose ate te kontrollit revizionit qe per behet nga nje kryetar dhe nga nje ose me shume eksperte. Keta nuk duhet te jene punonjes

te sheqerise apo te filialeve te mundeshme te saj. Komisioni i revisionit ose ekspertave kontabel edhe pergjegjes per veprimet e tij vetem para Ortakut te vetem te cilit i paraqet raporte me shkrim per kontrollin e kryera.

Neni 19

Ortaku i vetem ka te drejte edhe largimin nga detyra te Drejtorit Ekzekutiv dhe vendosjen ne kete post te ndonje personi tjeter.

Neni 20 Sheqeria pushon veprimtarine e saj ne odo rast qe vendos Ortaku i vetem. Kur vendoset nje gje e tille Ortaku i vetem emerohet komisionin e likuidimit i cili duhet te paraqes bilancin e likuidimit.


Sheqeria i jep fund veprimtarise es saj kur Ortaku i vetem miraton bilancin e likuidimit. Mejtete financiare te fituara apo kapitali themelor i Sheqerise, pas likuidimit te krediterëve merret nga Ortaku i vetem.

Neni 21

Ky Statut u redaktua ne kater kopje te njejta e cila ka fuqi ligjore te njejte.

ORTAKU I VETEM

PARUK KABA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 4604 Rep.

V E R T E T I M

Ne Tirane sot me daten Njzetegjaste Prill 1995, ne zyrat e Neterise Tirane, u paraqit Paruk Kaba, me gjeneralitete dhe adrese si ne aktin e themelimit i cili deklaroi se kete Statut e ka redaktua me vullnetin e tij te lire dhe e ka nenshkruar regullisht.

N O T E R E
SHPRESA SPAHJU

PULLE TAKSE

